

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN GJEPALAJ, DURRËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Gjepalaj, Durrës**, me objekt: *“Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifatat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, etj”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.11.2011 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 11, datë 18.02.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 936/6, datë 19.02.2014, i ka rekomanduar z. Alfred Kokomani Kryetar i Komunës, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Të zbatohen detyrat e rekomanduara nga KLSH, duke kontabilizuar dhe kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar në shumën 991,980 lekë nga dy subjekte.

Brenda muajit mars 2014

2. Të hartohet plani për ngritjen e sistemit dhe kontrollit, si dhe metodologjia për zbatimin e tij, të hartohet dhe të miratohet Kodi Etik, të identifikohet dhe të krijohet regjistri i riskut, të futen procedurat antikorrupsion etj, në zbatim të nenit 8, 10, 12, 20 etj, të ligjit 10,296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

Brenda datës 31.3.2014

3. Të merren masat e nevojshme për regjistrimin e aseteve në ZVRPP Durrës, në zbatim të VKM – ve përkatëse dhe nenit 8 të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 *“Për pronat e paluajtshme të shtetit”* i ndryshuar.

Brenda muajit Maj 2014

4. Sektori i Taksave, të kryej parashikim real të të ardhurave vendore mbështetur në dhënat aktuale dhe realizimeve të mëparshme, duke i parashikuar në mënyrë analitike, për çdo lloj detyrimi dhe ndjekjen e arkëtimit të tyre në periudhe të mujore.

Brenda datës 30.3.2014

5. Zyra e tatim taksave, në bashkëpunim me Zyrën e financës të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e shumës 1,337,625 lekë nga 18 subjekte debitorë për tatimet dhe taksat lokale të pa paguara për vitet 2011, 2012 dhe 11 muajori 2013.

Brenda datës 30.3.2014

6. Komuna Gjepalaj të marrë masa e nevojshme për dhënien me qira të tokës bujqësore të pa ndarë dhe pyjet e kullotat në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 *“Për tokat bujqësore të pa ndara”* duke rritur efikasitetin e përdorimit të tyre në shërbim të komunitetit.

Brenda muajit Maj 2014

7. Zyra e financës të kryej inventarizimi fizik të aseteve të qëndrueshme, të sistemojë në inventar dhe në kontabilitet sipas analizave *“Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara”* të cilat prej vitesh paraqiten pa emërtime ose vetëm me vlerën e rikonstruksioneve e sistemeve të kryera.

Të hartoj “Regjistrin e aktiveve dhe dokumentimin e lëvizjes së tyre” për të gjithë asetet e komunës në zbatim të ligjit 10,296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dalë në zbatim të tij.

Brenda datës 28.2.2014

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **773,273 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Vlera 560,625 lekë gjithsej, nga e cila subjektit M.T., D.B. dhe A.Xh. 166,875 lekë secili, kurse subjektit “E...” sh.p.k. dhe “B...R...” sh.p.k. nga 60,000 lekë secili, e cila përfaqëson pagesë më pak se sa e përcaktojnë llogaritjet për taksat, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Brenda muajit Mars 2014

2. Vlera 194,648 lekë z. G.B. me detyrë ish drejtor i shkollës në Gjepalaj, për shkak se nga inventari i ushtruar, i mungojnë 4 kompjuterë të cilët i ka pasur në ngarkim, në kundërshtim me pikën 73, 74 etj, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Brenda muajit Mars 2014

3. Vlera 18,000 lekë për pesë punonjës nga e cila:

- Z. P.P. 4,000 lekë,
- Z. K.S. 2,000 lekë,
- Z. D.K. 4,000 lekë,
- Z. H.Sh. 4,000 lekë,
- Zj. M.T. në shumën 4,000 lekë,

për shkak se në pagesat e kryera nuk janë llogaritur dhe ndalur detyrimet për tatimin mbi të ardhurat, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” dhe nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, kërkohet të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës”,

1. Zj. L.S., me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës, pasi :

- Ka plotësuar me mangësi pasqyrat financiare të vitit 2011 dhe 2012, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM nr. 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.
- Nuk ka dokumentuar lëvizjen e vlerave materiale nga magazina, në kundërshtim me pikat 95, 96 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011.
- Nuk ka kontabilizuar dhe ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e shumës 991,980 lekë sipas rekomandimeve të KLSH-së në auditimin e mëparshëm.

- Nuk ka kryer veprimet e nevojshme ligjore për regjistrimit në ZVRPP Durrës dhe në regjistrat kontabël, asetet në mbështetje të VKM – ve përkatëse.

2. Z. D.S., me detyrë përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave, pasi:

- Nuk ka arkëtuar detyrimet për taksat lokale nga 5 subjekte në shumën **560,625** lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

- Nuk ka plotësuar dosjet e subjekteve taksapagues me dokumentacionin e nevojshëm ligjor, në kundërshtim me nenin 12, 23, 29, 40, 68 të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me ndryshimet etj.

- Nuk ka zbatuar e masat e nevojshme shtrënguese për vjeljen e detyrimeve të pa paguara për shumën 1,337,625 lekë nga 18 subjekte debitorë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar etj.

- Nuk ka kryer rakordimin e të ardhurave të realizuara nga taksa për regjistrimin e përvitshëm të automjeteve, me Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe ZVRPP Durrës, në kundërshtim me nenin 28, 30 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 i ndryshuar.

- Në kryerjen e inventarizimit të vlerave materiale për vitin 2012, në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit, ka lënë gjendje në inventar mjete të ndryshme, kur ato mungojnë, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011.

3. Z. L.V., me detyrë inspektor i mbrojtjes së tokës, pasi:

- Nuk ka përgatitur dhe çuar në Këshillin e Komunës rezultatet e ri inventarizimit të 50 ha tokave bujqësore të pa ndara dhe dhënien me qira e tyre, në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pa ndara” dhe nenin 6, 7, 11, 12 të ligjit nr. 10,263, datë 8.4.2010 “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pa kultivuara” etj.

- Në kryerjen e inventarizimit të vlerave materiale për vitin 2012, në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit, ka lënë gjendje në inventar mjete të ndryshme, kur ato mungojnë, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011.

4. Z. M.T., me detyrë inspektor i pyjeve dhe kullotave, pasi:

- Nuk ka kryer procedurat e nevojshme teknike dhe ligjore për regjistrimin e 52,45 ha pyjeve, kullotave dhe në pronësi të komunës, në ZVRPP Durrës, në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar.

- Nuk ka përgatitur dhe dërguar për miratim materialin për dhënien me qira të kullotave, pyjeve dhe pesë rezervuarëve, në kundërshtim me nenin 19 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar etj.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Fatmir Zilja, Josif Lile dhe Margarit Stefa, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga Helga Vukaj, Drejtori i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT